



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 125 Prot

Tiranë, më 23.07., 2009

VENDIM Nr. 9 dt. 20.07.2009

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.07.2009,

VENDOSI:

1. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Korçës:

- Të mos vendosen tezga në sheshin para ballit nga jashtë. Ky të gjelbërohet në një raport $70\% \times 30\%$.
- Në rrugicat e Pazarit të kryhet restaurimi dhe plotësimi i kalldrëmit sipas teknikës ekzistuese.
- Të riparohen trotuaret me rrasë guri rrëth dyqaneve me teknikën ekzistuese.
- Në rast se do të ndërhyhet në suvatimet e dyqaneve duhet të hartohen projekte mes Bashkisë Korçë dhe IMK.
- Të hiqet ndriçimi nga poshtë dhe të bëhet nga sipër sipas praktikës tradicionale (Bashkia Korçë + IMK).
- Kalldrëmi i sheshit Qëndro të Pazarit të kryhet me rrasë guri.
- Mbi dyqane të vendosen strehë mbrojtëse, me xham të tejdukshëm me profile të lehta metalike.
- Firma që do të kryejë punimet në Pazar të jetë në kontakte të vazhdueshme me DRKK Korçë dhe me IMK(e cila dhe do të mbikqyrë punimet).

2. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Shkodrës:

- Në rrugën Branko Kadia shtresa e kalldrëmit të realizohet me gur gëlqeror pllakë me syprinë e lëmuar. Forma e pllakave katërkëndore kënddrejtë të jetë me përmasa 20-25cmx40cm. Me po këto lloj pllakash të trajtohen edhe kanalet edhe pusetat përkatëse.
- Kunetat e shkarkimit të ujërave të jenë në aks të shtresës si dhe kapakët e

pusetave të jenë prej guri.

- Stolat të realizohen të kombinuara me dru dhe metal.
- Gjelbërimi të bëhet i ulët dhe dekorativ sipas karakteristikës vendore, në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër.
- Të vendosen ndriçues dekorativ tradicional tip kollonë, në bashkëpunim me IMK, DRKK Shkodër dhe me Bashkinë Shkodër.
- Sinjalistika rrugore të realizohet me tabelat përkatëse me shigjeta.

3. Për ndërhyrjet në objektet e trashëgimisë kulturore në qytetin e Elbasanit:

- Trotuaret e rrugës aksiale të Kalasë të realizohen me pllaka katërkëndëshe gjëlqeror ose shtuf.
 - Shtresa e rrugës të realizohet sipas teknikës tradicionale me gur lumi të vendosur ratë dhe këlliç. Aksi i rrugës të realizohet me dy linja ngjitur tipike për kalldrëmet e rrugicave të Kalasë. (referohu në studimin “Recovering and improving Elbasan Fortress” by Roberto Pierini, Pisa University Press, fq. 203-205)
 - Në përputhje me rekomandimin për Kalanë e Elbasanit nga pikëpamja teknike ndriçimi të kryhet me tip kollone si në rastin e Shkodrës. (IMK+Bashkia Elbasan)
 - Në hyrjen lindore të Kalasë të kryhet sondazhi për zbulime të traktit origjinal të Via Egnatias në bashkëpunim me ASHA dhe IMK).
 - Mënyra e ekspozimit të këtij Trakti do të zgjidhet më tej në varësi të gjurmëve të zbuluara ose jo.
 - Shtresat mbajtëse të kenë trashësi të përshtatshme dhe në përputhje me trafikun lokal.
-
- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
 - Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
 - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ARDJAN TURKU


SEKRETAR I KKR
PROF. DR. VALTER SHTYLLA